



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ENERGJISË  
DHE INDUSTRIË  
URDHËR

Nr. 251, datë 16 . 6 .2017

**PËR  
SHËRBIMIN E DHËNIES SË INFORMACIONIT DHE SHFRYTËZIMIT TË  
DOKUMENTEVE TË MINISTRISË SË ENERGJISË DHE INDUSTRIË DHE PËR  
PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË KËTIJ SHËRBIMI**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, nenit 13 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe të nenit 77 të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, me propozim të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë,

**URDHËROJ:**

1. Kërkesat e personave fizikë, juridikë, publikë ose privatë, për dhënie informacioni dhe/ose vënie në dispozicion të dokumenteve të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, plotësohen kundrejt tarifave të përcaktuara.
2. Tarifa është kostoja e riprodhimit të informacionit dhe/ose dokumentacionit të kërkuar dhe, kur është rasti, edhe e dërgimit të tij.
3. Tarifat për dhënie e informacionit dhe/ose vënies në dispozicion të dokumenteve, janë si më poshtë:
  - a. 1 deri në 10 fletë informacioni përfitohet pa pagesë
  - b. Fotokopje bardhë e zi, / 11 deri në 100 fletë = 9 lek/copa  
Format A4 / mbi 100 fletë = 5 lek/copa
  - c. Printime bardhë e zi / 11 deri në 100 fletë = 9 lek/copa  
/ mbi 100 fletë = 5 lek/copa
  - ç. Printime me ngjyra / 11 deri në 100 fletë = 20 lek/copa  
/ mbi 100 fletë = 10 lek/copa
  - d. Skanime / 11 deri në 50 skanime = 25 lek/copa  
/ 51 deri në 100 skanime = 20 lek/copa  
/ mbi 100 skanime = 10 lek/copa
  - dh. Tarifa e CD-së / 50 lek
  - e. Shërbimi postar / 200 lek
  - ë. Riprodhimi i planshetave do mundësohet jashtë institucionit, sipas shërbimit privat

4. Informacioni i kërkuar në rrugë elektronike, në rastet kur disponohet elektronikisht nga institucioni, jepet falas. Në rast se informacioni i kërkuar nuk disponohet elektronikisht dhe për tu përshtatur në formë të tillë, ka nevojë për përpunim të mëtejshëm (skanime) nga nëpunësi i ngarkuar me këtë detyrë, shërbimi do të kryhet përkundrejt pagesës në përputhje me pikën 3/d të këtij urdhëri.
5. Personat që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe subjektet përfituese, sipas ligjit nr. 10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, të ndryshuar, e përfitojnë informacionin dhe/ose dokumentacionin falas, pas vërtetimit të statusit përkatës.
6. Riprodhimi i dokumenteve të kërkuara do të bëhet nga drejtoria që lëshon informacionin, me mjetet e riprodhimit që disponon Ministria e Energjisë dhe Industrisë. Për rastet e planshetave të cilat institucioni nuk ka mundësinë e riprodhimit atëherë institucioni këtë shërbim do ta sigurojë jashtë institucionit sipas tarifave që ofron tregu i lirë.
7. Pagesa e tarifës bëhet kundrejt një mandat pagese, pranë një banke të nivelit të dytë me numër llogarie 1093001 MEI të miratuar nga Ministria e Financave, ku përfshihet Kodi i Institucionit dhe Kodi i të ardhurave me nr. 7110105 “Tarifa për aktet administrative”.
8. Përlllogaritja e faturës bëhet nga drejtoria përgjegjëse, e cila detyrohet të vendosë në dispozicion dokumentacionin, dhe konfirmohet nga Koordinatori i Medias dhe Drejtori i Financës. Në rastet e riprodhimit të planshetave jashtë institucionit, fatura e lëshuar nga shërbimi privat do t'i bashkëngjitet faturës së institucionit.
9. Materialet e riprodhuara i dorëzohen kërkuarit pas paraqitjes së mandat arkëtimit pranë koordinatorit për të drejtën e informimit.
10. Kërkuari nuk mund të shumëfishojë për qëllime shitje informacionin dhe/ose dokumentacionin e marrë sipas këtij urdhëri.
11. Publikimi i tarifave të përcaktuara në pikën 3 të këtij urdhëri bëhet në faqen zyrtare në internet të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, si dhe më mjediset e pritjes së publikut.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**DAMIAN GJIKNURI**

